Republika e Kosovës

*Komuna e Rahovecit*

**Kabineti i Kryetarit**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2382 Nr. i faq/Br.str/No.pg 9
Data/Datum/Date 4 / 7 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

**LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: QERSHOR 2022**

| Nr | Emri i vendimit | Nr. Protokollit |
|---|---|---|
| 1. | Vendim për caktimin e Këshillit Organizues për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës | NRP-02-2216-2022 |
| 2. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-218-2022 |
| 3. | Vendim për formimin e Komisionit të Rekrutimit për zhvillimin e procedures së pranimit në punë specialist i bujqësisë, pyjeve dhe tokës | NRP-02-2219-2022 |
| 4. | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për përzgjedhjen e përfituesve për renovimin e shtëpive të banimit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian | NRP-02-2221-2022 |
| 5. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2222-2022 |
| 6. | Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës | NRP-02-2223-2022 |
| 7. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2227-2022 |
| 8. | Vendim për caktimin e Këshillit Organizues për nder të 17 Qershorit, ditëlindjes së Ukshin Hotit | NRP-02-2228-2022 |
| 9. | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për ndarjen e decorates "Ukshin Hoti" | NRP-02-2231-2022 |
| 10. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e pronës komunale për këmbim | NRP-02-2232-2022 |
| 11. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2235-2022 |
| 12. | Vendim për derivate | NRP-02-2243-2022 |
| 13. | Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës | NRP-02-2244-2022 |
| 14. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për student | NRP-20-2245-2022 |
| 15. | Vendim për pagesën e punës shtesë jashtë orarit të punës | NRP-02-2246-2022 |
| 16. | Vendim për pagesën e punës shtesë jashtë orarit të rregullt | NRP-02-2247-2022 |
| 17. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2208-2022 |
| 18. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve në bujqësi | NRP-02-2262-2022 |
| 19. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2263-2022 |
| 20. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2264-2022 |
| 21. | Vendim për punë shtesë | NRP-02-2268-2022 |
| 22. | Vendim për ditë pushimi për nder të 14 Qershorit Ditës së Çlirimit të Rahovecit | NRP-02-2269-2022 |

| | | |
|---|---|---|
| 23. | Vendim për dhënien e decorates "Ukshin Hoti" | NRP-02-2273-2022 |
| 24. | Vendim për mbulimin e pagesës së 15% të polices së sigurimit të produkteve bujqësore | NRP-02-2274-2022 |
| 25. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-2281-2022 |
| 26. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2284-2022 |
| 27. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2285-2022 |
| 28. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2286-2022 |
| 29. | Vendim për formim komisioni për vlerësimin dhe zhvillimin e procedures për lëvizhen Brenda kategorisë | NRP-02-2289-2022 |
| 30. | Vendim për formim Komisioni të Rekrutimit për zhvillimin e procedures së pranimit në punë | NRP-02-2290-2022 |
| 31. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2292-2022 |
| 32. | Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës | NRP-02-2293-2022 |
| 33. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e gjendjes së aseteve dhe objektit të zyrës së vendit në fshatin Ratkoc | NRP-02-2296-2022 |
| 34. | Vendim për caktimin e Grupit Punues për plotësimin e indikatorëve në Çmimin Evropian të Ekselences në Qeverisje në Kosove | NRP-02-2297-2022 |
| 35. | Vendim për caktimin e komisionit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2022 të Zyrës Kombëtare të Auditimit | NRP-02-2298-2022 |
| 36. | Vendim për kompensim pagese | NRP-02-2300-2022 |
| 37. | Vendim për kompensim pagese | NRP-02-2301-2022 |
| 38. | Vendim për kompensim pagese | NRP-02-2302-2022 |
| 39. | Vendim për kompensim pagese | NRP-02-2303-2022 |
| 40. | Vendim për kompensim pagese | NRP-02-2304-2022 |
| 41. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-2311-2022 |
| 42. | Vendim për pagesën e punës shtesë jashtë orarit të rregullt | NRP-02-2312-2022 |
| 43. | Vendim për emërimin e komisionit për vlerësimin e pasurive jo financiare dhe financiare jashtë përdorimit | NRP-02-2316-2022 |
| 44. | Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës | NRP-02-2319-2022 |
| 45. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-2328-2022 |
| 46. | Vendim për ekzekutimin e mjeteve financiare | NRP-02-2329-2022 |
| 47. | Vendim për formimin e komisionit për regjistrimin e sendeve të luajtshme | NRP-02-2335-2022 |
| 48. | Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës | NRP-02-2343-2022 |
| 49. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-2344-2022 |
| 50. | Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt propozimeve nga projekti ReLOaD2 | NRP-02-2345-2022 |
| 51. | Vendim për caktimin e komisionit për asgjesimin e mallit të konfiskuar | NRP-02-2346-2022 |
| 52. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-2347-2022 |
| 53. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave | NRP-02-2348-2022 |
| 54. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-2351-2022 |
| 55. | Vendim për lejimin e udhëtimit zyrtar | NRP-02-2352-2022 |
| 56. | Vendim për pagesën e shpërblimit të përvjetorit | NRP-02-2362-2022 |

| | | |
|---|---|---|
| 57. | Vendim për caktimin e Shtabit komunal për korrje-shirje për vitin 2022 | NRP-02-2363-2022 |
| 58. | Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve material dhe financiare në SHFMU "31 Marsi" në fshatin Guri i Kuq | NRP-02-2371-2022 |
| 59. | Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës | NRP-02-2372-2022 |

Rahovec, qershor 2022

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR - RAHOVEC ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 7 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

## Për caktimin e Këshillit Organizues për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës

1. Caktohet Këshilli Organizues për nder të 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
   - **1.1** Fatmir Iska, kryesues
   - **1.2** Afrim Dina, anëtar
   - **1.3** Defrim Kafexhiu, anëtar
   - **1.4** Feriz Thaçi – Përfaqësues i OVL-UÇK, anëtar
   - **1.5** Qemajl Krasniqi, anëtar
   - **1.6** Blerta Gashi, anëtare
   - **1.7** Avni Morina, anëtar
   - **1.8** Saranda Rama, anëtare
   - **1.9** Nora Boshnjaku, anëtare
   - **1.10** Muharem Morina, anëtar
   - **1.11** Saranda Sallteku, anëtare
   - **1.12** Besnik Hoti, anëtar
   - **1.13** Naser Dula, anëtar

2. Këshilli ka për detyrë të ndërmarr të gjitha veprimet organizative për shënimin e 14 Qershorit, Ditës së Çlirimit të Komunës, dhe atë shpërndarjen e ftesave për grupe dhe individë të rëndësishëm për pjesëmarrje, të bëjë ndarjen e mirënjohjeve, të bëjë rregullimin e vendit ku do të zhvillohen aktivitetet.

3. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative për shënimin e Ditës së Çlirimit të Komunës së Rahovecit i takon Kryesuesit të Këshillit Organizues.

4. Këshilli Organizues është i obliguar që t'i raportoj Kryetarit të Komunës mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjithë anëtarët e Këshillit Organizues.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e Këshillit Organizues,***
- ***Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2216 Nr. i faq/Br.str/No.pg 385
Data/Datum/Date 2 / 6 / 22

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2218 Nr. i faq/Br.str/No.pg 325
Data/Datum/Date 3/6/22

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit", me Nr. prokurimi: 623-22-4278-5-2-1 & 623-22-015-5-2-1, të datës: 2.6.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Diellza Çanta, kryesuese
   **1.2.** Fidan Hoti, anëtar
   **1.3.** Liridon Gashi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për "Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit", me Nr. prokurimi: 623-22-4278-5-2-1 & 623-22-015-5-2-1, të datës: 2.6.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2219 Nr. i faq/Br.str/No.pg 385
Data/Datum/Date 3 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 34 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosoves, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës së Rahovecit merr këtë:

# V E N D I M

I. Me këtë vendim formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimit në punë specialist i bujqësisë, pyjeve dhe tokës sipas konkursit RN00008928 për pozitën: Zyrtar teknik i pylltarisë pranë Drejtorisë për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural, në këtë përbërje:

1. Ymret Reshiti, kryesues
1.1.Agron Thaqi, zëvendësues
2. Jeton Kryeziu, anëtar
2.1.Isak Hoti, zëvendësues
3.Asllan Mazreku, anëtar
3.1.Neki Krasniqi, zëvendësues
4.Habibe Haxhimustafa,anëtare
4.1.Ylfete Kryeziu, zëvendësuese
5.Skender Kokollari, anëtar( ekspert)

II. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosoves .

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.

IV. Me vendim të njoftohet komisioni, Udhëheqësi i Personelit si dhe arkiva.

V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**K R Y E T A R I**

Smajl Latifi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2221 Nr. i faq/Br.str/No.pg 385
Data/Datum/Date 3 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017 dhe Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet OJQ Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve dhe Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 02/1848/22 të datës 06.04.2022 Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për përzgjedhjen e përfituesve për renovimin e shtëpive të banimit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për përzgjedhjen e përfituesve për renovimin e shtëpive të banimit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, në këtë përbërje:
   **1.1** Lendrit Qeli, kryesues
   **1.2** Jetmir Ukaj, anëtar
   **1.3** Violeta Thaqi – OJQ Voice of roma, ashkali and egyptian, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për përzgjedhjen e përfituesve për renovimin e shtëpive të banimit të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, duke u bazuar në njoftimin për aplikim të shpallur nga Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim në Komunën e Rahovecit me Nr. Prot. 03/22 të datës 21.04.2022.

3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në njoftimin për aplikim të shpallur nga Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim në Komunën e Rahovecit me Nr. Prot. 03/22 të datës 21.04.2022.

4. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve të renovimit të shtëpive.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim në Komunën e Rahovecit.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***ZKKK-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017 dhe kërkesës së z. Liridon Isakaj nr. prot. 33 të datës 10.01.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. **Miratohet** kërkesa e z. Refki Avdullahu, me bashkëshorten dhe dy fëmijë (vajza), për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit) si rast në nevojë sociale në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, respektivisht prej datës: 1.6.2022 deri më 31.8.2022, te pronari Avnija Raba në rrugën Xhelal Hajda – Toni pa nr. në Rahovec.

2. **Pagesa** në emër të qirasë do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.

3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën e Rahovecit që sipas autorizimit ligjor të lidh marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.

4. Përfitues nga pika 1 të këtij vendimi është prindi me bashkëshorten dhe dy femijë, Refki Avdullahu, i lindur me 10.5 1983, bashkëshortja Nurishahe Hamza, dhe fëmijët Rumejsa Avdullahu e lindur me 3.2.2016 dhe Blerta Avdullahu e lindur me 24.05.2018

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me dy fëmijë të moshës gjashtë dhe katër vjeq e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qera, ku të vetmin burim të të ardhurave i ka nga Skema e Ndihmave Socila, shumë e cila është e pamjaftueshme për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet.
Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së, duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2222 Nr. i faq/Br.str/No pg 385
Dat./Datum/Date 3/6/22

REPUBLIKA E KOSOVËS / KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS / RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së z. Liridon Isakaj nr. prot. 33 të datës 10.01.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. **Miratohet** kërkesa me nr. prot. 1413 e dt. 26.04.2022, e znj. Sevdije Berisha, e cila jeton me fëmijën jetim, për strehim të përkohshëm emergjent(vazhdimi i strehimit) si rast në nevojë sociale në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, respektivisht prej datës 01.06.2022 deri më 31.08.2022, tek pronari Lirije Cena në rrugën Dëshmorët e Pashtrikut pa nr. në Rahovec.

2. **Pagesa** në emër të qirasë do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.

3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën e Rahovecit që sipas autorizimit ligjor të lidh marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.

4. Përfitues nga pika 1 të këtij vendimi është zonja Sevdije Berisha e lindur 08.07.1967 dhe mbesa e saj Erisa Berisha.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me femijën të moshës dy vjeq e që nuk kan ku të strehohen, jetojnë me qera, ku të vetmin burim të të ardhurave i ka nga Skema e Ndihmave Socila, shumë e cila është e pamjaftueshme për ti mbuluar të gjitha shpenzimet.
Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së, duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Arkivit.***

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2227 Nr. i faq/Br.str/No.pg 386
Data/Datum/Date 6 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine / Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1228 Nr. i faq/Br.str/No.pg 386
Data/Datum/Date 6 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e Këshillit Organizues për nder të 17 Qershorit, ditëlindjes së Ukshin Hotit

1. Caktohet Këshilli Organizues për nder të 17 Qershorit, ditëlindjes së Ukshin Hotit, në këtë përbërje:
   - **1.1** Afrim Dina, kryesues
   - **1.2** Berat Duraku, anëtar
   - **1.3** Qemajl Krasniqi, anëtar
   - **1.4** Blerta Gashi, anëtare
   - **1.5** Muharem Morina, anëtar
   - **1.6** Nora Boshnjaku, anëtare
   - **1.7** Feriz Thaçi, anëtar
   - **1.8** Arben Fetoshi, anëtar
   - **1.9** Saranda Sallteku, anëtare
   - **1.10** Avni Morina, anëtar
   - **1.11** Dafina Gashi, anëtare

2. Këshilli ka për detyrë të ndërmarr të gjitha veprimet organizative për shënimin e 17 Qershorit, ditëlindjes së Ukshin Hotit, dhe atë shpërndarjen e ftesave për grupe dhe individë të rëndësishëm për pjesëmarrje, të bëjë rregullimin e vendit ku do të zhvillohen aktivitetet, ndarjen e Çmimit "Ukshin Hoti", etj.

3. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësive për pjesën operative për shënimin e 17 Qershorit, ditëlindjes së Ukshin Hotit i takon Kryesuesit të Këshilit Organizues.

4. Këshilli Organizues është i obliguar që t'i raportoj Kryetarit të Komunës mbi ecurinë, mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjithë anëtarët e Këshillit Organizues.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e Këshillit Organizues,***
- ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2231 Nr. i faq/Br.str/No.pg 386
Data/Datum/Date 6 / 6 / 22

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për themelimin e çmimit "Ukshin Hoti" me 01 Nr. 292/22 të datës 30.03.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për ndarjen e dekoratës "Ukshin Hoti"**

1. Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për ndarjen e dekoratës "Ukshin Hoti", në këtë përbërje:

   **1.1.** Dr. Sabahajdin Cena, kryesues
   **1.2.** Agime Kadriu - profesoreshë, anëtare
   **1.3.** Durmish Gashi – veprimtar, anëtar
   **1.4.** Hysen Gashi – veprimtar, anëtar
   **1.5.** Qemajl Krasniqi – DKRS, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha propozimeve si dhe përzgjedhjen e personalitetit për ndarjen e dekoratës "Ukshin Hoti", duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për themelimin e çmimit "Ukshin Hoti" me 01 Nr. 292/22, të datës: 30.03.2022.

3. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë: 13 qershor 2022, kur edhe do t'i rekomandojë Kryetarit të Komunës personalitetin e vitit për ndarjen e dekoratës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen anëtarët e Komisionit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Anëtarëve të komisionit,*
- *Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, dhe*
- *Arkivit.*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit*

*Opština Orahovac/ Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Prešednik Opstine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 2232 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 326
Data/Datum/Date 7 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës i datës 07.03.2019, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**

**Për caktimin e Komisionit për vlerësimin e pronës komunale për këmbim**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e pronës komunale për këmbim me pronën private, në përbërje prej:
   - **1.1** Arben Gashi, kryesues
   - **1.2** Miftar Krasniqi, anëtar
   - **1.3** Ekrem Bytyqi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e Pronës Komunale me Nr. P-71510066-00944-0 në Zonën Kadastrale Pastasellë, në posedim të Komuna e Rahovecit e cila është rezultat i këmbimit me pronën e Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K. Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve, Rahovec me Nr. P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë, se nuk ekzistojnë prona tjera komunës të përshtatshme për qëllimin e këmbimit.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

1. ***Anëtarëve të komisionit,***
2. ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
3. ***Arkivit.***

Smajl Latifi

Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2235 Nr. i faq/Br.str/No pg. 387
Data/Datum/Date 8 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427, të datës: 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e Shoqatës Operacioni Shigjeta me Nr. Protokolit 1778, e dt. 20.05.2022 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind e pesëdhjetë) për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e manifestimit me rastin e përvjetorit të Operacionit Shigjeta.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

## *Arsyetim*

Shoqata Operacioni Shigjeta, si shoqatë e veteranëve ka marrë përsipër organizimin e manifestimit me rastin e përvjetorit të Operacionit Shigjeta.
Duke marrë parasysh gjendjen e rëndë financiare të kësaj shoqate, është e arsyeshme që të përkrahet financiarisht për ruajtjen e vlerave kombëtare.
Andaj, me qëllim të përkrahjes së kësaj shoqate, është e domosdoshme ndihma financiare për organizimin e manifestimit me rastin e përvjetorit të Operacionit Shigjeta.
Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Vendimi u dërgohet :***

- ***Shoqatës Operacioni Shigjeta,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna Rahovec***
*OpštinaOrahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2243 Nr. i faq/Br.str/No pg. 387
Data/Datum/Date 9 / 8 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**

1. **MIRATOHET** kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Rahovec me Nr. Prot. 1987 të dt. 03.06.2022.

2. OVL - UÇK-së, i ndahen 50 (pesëdhjetë) litra naftë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të shoqatave të dala nga lufta për muajin qershor, të cilat janë në planprogramin e OVL – UÇK-së.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Administratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***OVL – UÇK-së në Rahovec,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Drejtorisë për Administratë, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
p.
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2244 Nr. i faq/Br.str/No pg 388
Data/Datum/Date 9 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 59 paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

## VENDIM
## PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

I.**ALBAN DURAKU** nga Krusha e Madhe, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Asistent administrativ 3 në Qendrën për Punë Sociale pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në shërbimin civil** nga data 30.05.2022.

II.Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që ta heq nga lista e pagave.

III.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### A r s y e t i m

**ALBAN DURAKU** nga Krusha e Madhe ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Asistent administrativ 3 në Qendrën për Punë Sociale pranë Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Alban Duraku me shkresën nr.2079/2022 e ka njoftuar Kryetarin e komunës me dorëheqjen e tij nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.

Sipas nenit 62 paragrafit 1 pika 1 e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon kur nëpunësi civil jep dorëheqje nga detyra.

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendos si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i palës së ndjerë ( të nëpunësit), ka të drejt ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK POSTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Alban Durakut
2. Drejtorisë për SHPS
3. Qendra për Punë Sociale
4. Dosja personale
5. Arkiva

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2245 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 388
Data/Datum/Date 9/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 9 dhe nenit 10 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 e dt. 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për student**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë, në këtë përbërje:
   - 1.1 Lulzim Krasniqi, kryesues
   - 1.2 Fiknete Kasapi-Iska, anëtare
   - 1.3 Arben Gashi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarje të bursave për student sipas dispozitave të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017.

3. Komisioni duhet të bëj shqyrtimin e ankesave dhe të marr vendim në afat prej 15 ditësh pas përfundimit të afatit kohor për paraqitjen e ankesave.

4. Obligohet komisioni që të veproj duke u bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 1427 të datës 28.04.2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve dhe në Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

5. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për studentë mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kritereve të përcaktuar me Rregullore për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve.

6. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave për ndarjen e bursave për student ka mandat 3 (tre) vjeçar.

7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Arsim.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI / PREDSEDNIK / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 246 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 388
Data/Datum/Date 9 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të nenit 21 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010, dispozitave të nenit 11 të Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, raportit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal për Grantin e Performancës Komunale me Nr. Prot. 02-258/2 të datës 26.04.2022, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për pagesën e punës shtesë jashtë orarit të punës**

1. Me këtë vendim **lejohet** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për muajin janar, shkurt dhe mars 2022, për anëtarët e Grupit punues për performancë komunale në Komunën e Rahovecit dhe atë si në vijim:
   **1.1.** Neki Krasniqi,
   **1.2.** Ekrem Bytyqi,
   **1.3.** Shedat Ukaj,
   **1.4.** Beqir Hamza,
   **1.5.** Shpejtim Mustafa,
   **1.6.** Fadil Bugari,
   **1.7.** Venhar Topalli,
   **1.8.** Masar Vuqitërna,
   **1.9.** Sylejman Daka,
   **1.10.** Dritan Sokoli,
   **1.11.** Senad Mullaavda,
   **1.12.** Agron Thaçi,
   **1.13.** Saranda Rama,
   **1.14.** Fidan Hoti,
   **1.15.** Jeton Krasniqi,
   **1.16.** Alban Gashi,
   **1.17.** Lulzim Krasniqi.

2. Të njëjtët kanë të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës që bënë për muajt e cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe atë 80 (tetëdhjetë) orë pune për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës në detyrën që u është caktuar nga Kryetari i Komunës për menaxhimin e Performancës së shërbimeve komunale.

3. Mjetet për pagesën e punës jashtë orarit të rregullt do të sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

Duke u mbështetur në Rregulloren e MAPL Nr. 02/2013 për Sistemin e Menaxhimin të Performancës së Shërbimeve Komunale, me vendim Nr. 02/584/20 të datës 30.04.2020 është formuar grupi punues për performancë të komunës, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin Nr. 02/1843/22 të datës 05.04.2022, i cili merret me sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale.

Me datë 26.04.2022 Ministria e Pushtetit Lokal ka shpallur Raportin për performancë komunale, në të cilën Komuna e Rahovecit është shpallur si komuna me performacë me të mirë dhe si rezultat i kësaj komuna ka përfituar Grantin në shumën prej 1,148,890.70€, i cili do të përdoret për investimet kapitale në komunë.

Andaj duke marrë parasysh punën e madhe të cilën e ka bërë grupi punues, pasi që kanë punuar edhe jashtë orarit për të arritur rezultatet e mira, është e domosdoshme pagesa për punë jashtë orarit, duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në Republikën e Kosovës.

Andaj, nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Grupit Punues,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2247 Nr. i faq/Br.str/No.pg 388
Data/Datum/Date 9 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 paragrafi 3 pika 3.1 i të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010 dhe nenit 11 paragrafi 6 pika 6.1 i Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
### Për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt

1. Me këtë vendim **lejohet** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës nga data 1 qershor 2022 për z. Mirsad Shala, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar Ligjor në Sektorin Ligjor, pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës.

2. I njëjti ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës që bënë për muajt e cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe atë 30% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.

3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe prodhon efekt juridik deri në marrjen e një vendimi tjetër.

*Arsyetim*

Duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve shtesë të caktuara nga Zyrtari Kryesor Administrativ në Komunën e Rahovecit për nëpunësin z. Mirsad Shala gjatë kësaj periudhe në Komunën e Rahovecit si dhe pas caktimit të tij menaxher i kontratës me vendimin Nr. 02/1498/22 të datës 31.1.2022, i lartpërmenduri është i detyruar që të punojë edhe jashtë orarit të rregullt të punës për ti kryer detyrat të cilat dalin nga vendi i punës dhe puna shtesë e caktuar si menaxher i kontratës, është e domosdoshme që të njëjtit t'i bëhet kompensimi me pagesë 30% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.
Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***
- ***Z. Mirsad Shala,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyra e personelit, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2208 Nr. i faq/Br.str/No.pg 3 & 4
Data/Datum/Date 30 / 5 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 22 paragrafi 1 pika 1.3 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. Erzen Zyberaj nga fsh. Drenoc, komuna e Rahovecit, me Nr. Protokolit 1879 të dt. 26.05.2022 për ndihmë financiare prej 600.00€ (gjashtëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të pjesëmarrjes në garën ndërkombëtare "Dagyenice Ultra Trail 2022".

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

z. Erzen Zyberaj si njëri nga shumë sportistët e pavarur dhe njëri nga sportistët më të dalluar të komunës së Rahovecit në atletik ka marrë pjesë në shumë gara sportive në nivel të Republikës së Kosovës dhe më gjerë.
I lartpërmenduri ka pranuar ftesën për pjesëmarrje në garën ndërkombëtare "Dagyenice Ultra Trail 2022" e cila do të mbahet në Bursa të Turqisë me datë 04.06.2022.
Andaj, duke marrë parasysh se i lartpërmenduri do të merr pjesë në këtë garë ndërkombëtare, është e domosdoshme mbulimi i shpenzimeve dhe përgatitja për të marr pjesë në këtë garë.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- *z. Erzen Zyberaj,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivi.*

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA – KOMUNA E RAHOVECIT – KRYETARI I KOMUNËS – MUNICIPALITY RAHOVEC – MUNICIPAL MAYOR – RAHOVEC ORAHOVAC

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2262 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 389
Data/Datum/Date 10/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve në bujqësi

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmeve në bujqësi sipas kërkesës me Nr. Prot. 2070 të datës 08.06.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Ilvi Durguti, kryesues
   **1.2.** Veton Mustafa, anëtar
   **1.3.** Milazim Elshani, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të konstatoj dhe të bëjë vlerësimin e dëmeve në bujqësi, respektivisht në kulturën e shalqinit, duke u bazuar në kërkesën me Nr. Prot. 2070 të datës 08.06.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Komisioni do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***DBPZHR, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2263 Nr. i faq/Br.str/No.pg 389
Data/Datum/Date 10 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e z. [redacted] Komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 2036, të dt. 06.06.2022 për ndihmë financiare prej 350.00€ (treqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve te mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Vëllau i [redacted] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërimin kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së vëllaut, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted] *nga fsh. Krushë e Madhe,*
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPALITY MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2264 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 390
Data/Datum/Date 10 / 6 / 22
RAHOVEÇ / ORAHOVAC


Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e Shoqatës së Pavarur të Gruas "Hareja" në Rahovec me Nr. Protokolit 1964 dt. 01.06.2022 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e manifestimit me rastin e ditës ndërkombëtare të fëmijëve.

2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

## *Arsyetim*

Shoqatës së Pavarur të Gruas "Hareja" në Rahovec është shoqatë e cila i trajton fëmijët dhe të rinjtë me nevoja të veçanta si dhe një numër të madh të fëmijëve të tjerë me aktivitete të ndryshme, kështu që me rastin e ditës ndërkombëtare të fëmijëve kjë shoqatë organizon program ku do të marrin pjesë fëmijë dhe të rinjtë me nevoja të veçanta
Andaj, me qëllim të përkrahjes së kësaj shoqate, është e domosdoshme ndihma financiare për organizimin e manifestimit me rastin e ditës ndërkombëtare për fëmijë me nevoja të veçanta.
Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Vendimi u dërgohet :***

- ***SHPG "Hareja" në Rahovec,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2268 Nr. i faq/Br.str/No.pg 390
Data/Datum/Date 10/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe punë të paparapara e Menaxherit të Projektit sipas kërkesës së datës: 10.06.2022 dhe raportit të Organit Mbikëqyrës me Nr. Prot. 2100 të datës: 10.06.2022, në projektin **"Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit"** me Nr. të Prokurimit **623-20-3607-5-1-1 / 623-20-033-5-1-1** në shumën prej **27,567.44€ (njëzet e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e dyzet e katër cent).**

2. Ky vendim merret, pasi që është konstatuar nga organi mbikëqyrës dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t'u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.

3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Menaxheri i Projektit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Zyrës së Prokurimit,***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Menaxherit të Projektit,***
- ***Organit Mbikëqyrës, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS / OPŠTINA ORAHOVAC / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPALITY RAHOVEC - MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2269 Nr. i faq/Br.str/No pg 390
Data/Datum/Date 10 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 7 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Që 14 Qershori, Dita e Çlirimit të Rahovecit, të jetë ditë pushimi**

1. Me këtë vendim data 14 qershor 2022 (e martë), për të gjithë punonjësit dhe institucionet e Komunës së Rahovecit, do të jetë ditë pushimi.

2. Data 14 qershor 2022 do të jetë ditë pushimi për nder të Ditës së Çlirimit të Rahovecit.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Arsim dhe Zyra e Personelit në Komunën e Rahovecit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

Duke u bazuar në Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, respektivisht në nenin 7 paragrafi 2 pika 2.1 është caktuar që 14 qershori është Dita e Çlirimit të Rahovecit, me këtë rast është përcaktuar si ditë feste e Komunës së Rahovecit.

Për këtë arsye, data 14 qershor 2022 (e martë) është caktuar ditë pushimi për të gjithë punonjësit dhe institucionet e Komunës së Rahovecit.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Drejtorët e drejtorive,***
- ***Njësia e Personelit,***
- ***Zyra për Informim, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC - MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna Rahovec*
*OpštinaOrahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Mayor Office**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2273 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 390
Data/Datum/Date 13 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008"), Vendimin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit për themelimin e çmimit "Ukshin Hoti" me 01 Nr. 292/22 të datës 30.03.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, dhe rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës "Ukshin Hoti" me Nr. Prot. 130 të datës 08.06.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM
### Për dhënien e dekoratës "Ukshin Hoti"

1. Me këtë vendim jepet dekorata "Ukshin Hoti" për z. Dervish Çadraku nga Malësia e Vogël (Radostë), Komuna e Rahovecit, i cili ishte i burgosur politik dhe veprimtar i shquar në etapa të ndryshme të rezistencës tonë kombëtare.

2. Dekorata "Ukshin Hoti" i jepet të lartpërmendurit më 17 qershor 2022, me rastin e ditëlindjes së 79-të të veprimtarit dhe profesorit Ukshin Hoti.

3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *Arsyetim*

Kuvendi i Komunës së Rahovecit me vendimin 01 Nr. 292/22 të datës 30. 3. 2022, themeloi çmimin "Ukshin Hoti", i cili do t'u jepet personaliteteve të shquara, familjeve emblematike dhe individëve që kanë kontribuuar për liri, dinjitet njerëzor dhe kombëtar, ruajtjen dhe kultivimin e vlerave historike kombëtare dhe atyre që janë shquar për vlerat e tyre humaniste e civilizuese.

Duke u bazuar në këtë vendim, Kryetari i Komunës me vendimin Nr. 02/2231/22 të datës 6. 6. 2022, caktoi komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për dhënien e dekoratës "Ukshin Hoti".

Komisioni pas mbledhjes së mbajtur dhe shqyrtimit të propozimeve për dhënien e dekoratës, i rekomandoi Kryetarit të Komunës z. Dervish Çadrakun nga Malësia e Vogël (Radostë), Komuna e Rahovecit, i cili ishte i burgosur politik dhe veprimtar i shquar në etapa të ndryshme të rezistencës tonë kombëtare.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Z. Dervish Çadraku nga Malësia e Vogël (Radostë),***
- ***Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo / Republic of Kosovo
### *Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63, 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, nenit 8, nenit 11, nenit 19 dhe nenit 20 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**

**Për mbulimin e pagesës së 15% të policës së sigurimit të produkteve bujqësore**

1. Me këtë vendim **lejohet** pagesa për mbulimin e 15% të policës së sigurimit të produkteve bujqësore (për vreshtari) për fermerët e komunës së Rahovecit, si në vijim:
   **1.1.** Bedri Ali Gashi, nga fsh. Drenoc në shumën prej 34.61€;
   **1.2.** Flamur Aliriza Haxhijaha, nga Rahoveci në shumën prej 10.14€;
   **1.3.** Isuf Sherif Gashi, nga fsh. Drenoc në shumën prej 86.43€;
   **1.4.** Nazmi Alush Gashi, nga fsh. Drenoc në shumën prej 45.48€;
   **1.5.** Besnik Liman Gashi, nga fsh. Drenoc në shumën prej 34.61€;
   **1.6.** Qazime Hazër Shehu, nga Rahoveci në shumën prej 101.84€;
   **1.7.** Avni Latif Xhafer, nga fsh. Drenoc në shumën prej 12.14€;
   **1.8.**Gani Ali Krasniqi, nga fsh. Senoc në shumën prej 11.60€.
2. Mjetet të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**Arsyetim**

Duke marrë parasysh se fermerët e Komunës së Rahovecit në vitet e fundit kanë pasur vështirësi të mëdha në kultivimin dhe shitjen në treg të produkteve të tyre bujqësore, pasi që Pandemia COVID-19 u ka sjell atyre vështirësi në shitje.

Pas kësaj, fermerët e komunës së Rahovecit muajt e fundit janë duke u përballur edhe me ngritjen enorme të çmimeve tjera elementare të cilat ndikojnë direkt në punën e tyre për punimin e tokave, me qëllim që produktet e tyre t'i nxjerrin në treg.

Andaj, duke u bazuar në këto rrethana dhe vështirësi, të cilat ndikojnë në punën e fermerëve të komunës së Rahoveci, është e domosdoshme subvencionimi dhe mbulimi i pagesës së 15% të policës së sigurimit të produkteve bujqësore, respektivisht në vreshtari, me qëllim të ndihmës dhe tejkalimit të kësaj gjendjeje të rëndë për fermerët e komunës sonë.

Andaj, nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Fermerëve të lartpërmendur,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2274 Nr. i faq/Br.str/No.pg 391
Data/Datum/Date 13 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opstine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2281 Nr. i faq/Br.str/No pg. 391
Data/Datum/Date 15/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Shërbime konsulentë individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-22-5173-2-1-1 & 623-22-019-2-1-1 të datës: 13.06.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues
   **1.2.** Arta Kabashi, anëtare
   **1.3.** Egzon Thaqi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për "Shërbime konsulentë individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit", me Nr. prokurimi: 623-22-5173-2-1-1 & 623-22-019-2-1-1 të datës: 13.06.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02 Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 2284 Nr. i faq/Br.str/No.pg 392
Data/Datum/Date 15 6 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.6 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 2106, të dt. 10.06.2022 për ndihmë financiare prej 200.00€ (dyqind euro) për mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Arsyetim***

[redacted] vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që jeton e vetme dhe nuk gëzon të ardhura financiare.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurës, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërim kanë kosto të lartë financiare, ajo e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted] *nga Krusha e Madhe,*
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2285 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 392
Data/Datum/Date 15/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.6 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] Komuna e Rahovecit me Nr. Protokolit 2105, të dt. 10.06.2022 për ndihmë financiare prej 200.00€ (dyqind euro) për mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

[redacted] nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe për këtë arsye gjendjen ekonomike dhe financiare në familje e ka të rënduar, duke marrë parasysh se jeton me dy fëmijë dhe se nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.

Për këtë arsye e lartpërmendura e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë, pasi që nuk ka të ardhura të vazhdueshme nga puna, dhe e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë për familje, gjë që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted] *nga Rahoveci,*
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
RAHOVEC ORAHOVAC

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2286 Nr. i faq/Br.str/No.pg 392
Data/Datum/Date 15/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.6 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] me Nr. Protokolli 2102, të dt. 10.06.2022 për ndihmë financiare prej 200.00€ (dyqind euro) për mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *Arsyetim*

[redacted] nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe për këtë arsye gjendjen ekonomike dhe financiare në familje e ka të rënduar, duke marrë parasysh se jeton në një familje 5 (pesë) anëtarëshe dhe se asnjë anëtar nuk është në marrëdhënie pune.

Për këtë arsye i lartpërmenduri e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë, pasi që të ardhurat e vetme financiare i ka nga bujqësia, të cilat nuk mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë për familje, gjë që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2289 Nr. i faq/Br.str/No.pg 392
Data/Datum/Date 16 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 38 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtaret Publik, nenit 46 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosoves, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës së Rahovecit merr këtë:

**V E N D I M**

1. Me këtë vendim formohet komisioni i vlerësimit për të zhvilluar procedurën për lëvizjen brenda kategorisë në konkursin RN00009028, për vendin e punës: Zyrtar/e për Informim pranë Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
   1. Ymret Reshiti, kryesues
   1.1. Agron Thaçi, zëvendësues
   2. Qemajl Krasniqi, anëtar
   2.1.Isak Hoti, zëvendësues
   3. Saranda Rama, anëtare
   3.1. Arta Kabashi, zëvendësuese
   4. Lendrit Qeli, anëtar
   4.1. Asllan Mazreku, zëvendësues
   5. Skender Hamza, anëtar
   5.1.Neki Krasniqi, zëvendësues

2. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06L-114 për Zyrtaret Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosoves .

3. Ky komision emërohet vetëm me grup të veçantë të pozitës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Udhëheqësi i personelit dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2290 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 392
Data/Datum/Date 16/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), në nenin 34 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosoves, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës, Kryetari i komunës së Rahovecit merr këtë:

**V E N D I M**

1. Me këtë vendim formohet Komisioni i Rekrutimit për të zhvilluar procedurën e pranimit në punë, një specialistë të gjeodezisë sipas Konkursit RN00008926 për pozitën: Zyrtar teknik i ndërtimit pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në këtë përbërje:
   1.Ymret Reshiti, kryesues
   1.1.Agron Thaqi, zëvendësues
   2. Sylejman Daka,anëtar
   2.1.Vadet Kadiri, zëvendësues
   3. Neki Krasniqi, anëtar
   3.1.Skender Hamza, zëvendësues
   4. Bjondina Ramaj, anëtare
   4.1. Flutura Beqiri, zëvendësuese
   5.Skender Kokollari, anëtar (ekspert)

2. Detyrat e komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosoves .

3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset komisioni.

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Udhëheqësi i personelit dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2292 Nr. i faq/Br.str/No.pg 392
Data/Datum/Date 16/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.6 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] komuna e Rahovecit me Nr. Prot. 2155, të dt. 15.06.2022 për ndihmë financiare prej 300.00€ (treqind euro) për mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

[redacted]uan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që jeton e vetme dhe nuk gëzon të ardhura financiare.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurës, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave për shërim kanë kosto të lartë financiare, ajo e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KRYETARI RAHOVECIT / OPŠTINA RAHOVEC / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPSTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2293 Nr. i fq/Br.str/No.pg 392
Data/Datum/Date 16 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 60 paragrafi 1 pika 3 e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114, si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës merr këtë:

**VENDIM**
**MBI PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

I. **ZIJAJDIN HAXHIMUSTAFA** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Teknik për sevi kultur pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 03.05.2022.

II. OBLIGOHET Drejtoria për Buxhet dhe Financa që punëtorin ta largon nga lista e pagave nga dt.03.05.2022.

III.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IV. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Punëtori **ZIJAJDIN HAXHIMUSTAFA** nga Rahoveci, në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Teknik për sevi kultur pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural **I PËRFUNDON MARRËDHËNIA E PUNËS** nga data 03.05.2022.

Sipas detyrës zyrtare Njësia e personelit ka konstatuar se punëtori i lartë përmendur me datë 02.05.2022, arrin moshën e pensionimit ngase i bënë 65 vjet.

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve, vërtetoi gjendjen faktike dhe vendosi që punëtorit Zijajdin Haxhimustafës nga data 03.05.2022, **I PËRFUNDON** marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit.

Nga sa u tha më lartë, Kryetari i komunës vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi punëtori ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Këshillit të Pavarur Mbikqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Punëtorit
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural
4. Dosja personale
5. Arkiva

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2296 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 17/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e gjendjes së aseteve dhe objektit të zyrës së vendit në fshatin Ratkoc**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e gjendjes së aseteve dhe objektit të zyrës së vendit në fshatin Ratkoc, në këtë përbërje:

   **1.1.** Sulejman Daka, kryesues
   **1.2.** Gzim Zeka, anëtar
   **1.3.** Asllan Mazreku, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të konstatoj dhe të bëjë vlerësimin e aseteve dhe objektit të zyrës së vendit në fshatin Ratkoc.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Komisioni do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Administratë.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Administratë, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2297 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 17 / 6 / 22
RAHOVEC ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e Grupit Punues për plotësimin e indikatorëve në Çmimin Evropian të Ekselencës në Qeverisje (ELoGE) në Kosovë**

1. **Caktohet** Grupi Punues për plotësimin e indikatorëve në Çmimin Evropian të Ekselencës në Qeverisje (ELoGE) në Kosovë, në këtë përbërje:
   **1.1** Bjondina Ramaj-Fazliu – Zyrtare për mbrojtje të mjedisit, koordinatore
   **1.2** Blerta Gashi – Zyrtare për informim, anëtare
   **1.3** Alban Gashi – Zyrtarpër barazi gjinore, anëtar
   **1.4** Arben Gashi – Zyrtar për integrim evropiane, anëtar
   **1.5** Skender Hamza – Zyra e Kuvendit, anëtar
   **1.6** Agron Thaqi – Zyra e Personelit, anëtar
   **1.7** Senad Mullaavda – përkthyes, anëtar
   **1.8** Habibe Haxhimustafa – Zyra për barazi gjinore, anëtare
   **1.9** Jeton Krasniqi – Zyrtar i arsimit, anëtar
   **1.10** Zyber Thaqi – Zyrtar financiar, anëtar
   **1.11** Ilir Haxhijaha – Zyrtar Ligjor, anëtar
   **1.12** Petrit Haxhijaha – Zyrtar i IT, anëtar
   **1.13** Burim Lezi – Zyrtar i KKZ në Rahovec, anëtar

2. Grupi punues ka për detyrë që të bëjë plotësimin e përgjigjeve për indikatorët në 12 parimet e qeverisjes së mirë demokratike për Çmimin Evropian të Ekselencës në Qeverisje (ELoGE) në Kosovë.
3. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 20 korrik 2022.
5. Obligohet grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjithë anëtarët e Grupit Punues për plotësimin e indikatorëve në Çmimin Evropian të Ekselencës në Qeverisje (ELoGE) në Kosovë.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- *Anëtarëve të Grupit Punues,*
- *Arkivit*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI/PREDSEDNIK OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2298 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 17/6/22
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2022 të Zyrës Kombëtare të Auditimit**

1. **Caktohen** anëtarët e komisionit për zbatimin e rekomandimeve për vitin 2022 të dalura nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
   **1.1.** Fatmir Iska, kryesues
   **1.2.** Berat Duraku, anëtar
   **1.3.** Erhan Morina, anëtar
   **1.4.** Përparim Krasniqi, anëtar
   **1.5.** Avni Morina, anëtar
   **1.6.** Afrim Limani, anëtar
   **1.7.** Astrit Mullabazi, anëtar
   **1.8.** Saranda Sallteku, anëtare
   **1.9.** Ruzhdi Kabashi, anëtar
   **1.10.** Afrim Dina, anëtar
   **1.11.** Albnor Mullabazi, anëtar

2. Anëtarët e komisionit kanë për detyrë zbatimin e rekomandimeve për vitin 2022 të dalura nga Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për Komunën e Rahovecit.

3. Obligohen anëtarët e Komisionit që të veprojnë duke u bazuar në raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe anëtarët e komisionit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendim u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2300 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 20/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 22 të paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil si dhe nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

**V E N D I M**

I.**BAJRAM BEKERI** nga Rahoveci, ish shërbyes civil i administratës komunale të Rahovecit i bëhet kompensimi i një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, në emër të daljes në pension.

II.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

III.Mjetet paguhen prej pozicionit buxhetor të mallrave dhe shërbimeve.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**BAJRAM BEKERI** nga Rahoveci, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Udhëheqës i Ekipit të Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale /Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje dhe nga dt.18.07.2021 i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit sipas Vendimit e Kryetarit të komunës nr.716 dt.07.07.2021.

Sipas nenit nenit 22 paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 Për pagat e nëpunësve civil thuhet se nëpunësit civilë kanë të drejtat në " pagesën për shkak të pensionimit".

Gjithashtu, me nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë thuhet se **"nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore ."**

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i palës së ndjerë ( të nëpunësit), ka të drejt ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Bajram Bekerit nga Rahoveci
2. Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
3. Dosja personale
4. Arkiva

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2301 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 20/06/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 22 të paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil si dhe nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

**V E N D I M**

I.**BINAK KRYEZIU** nga Retija, ish shërbyes civil i administratës komunale të Rahovecit i bëhet kompensimi i një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, në emër të daljes në pension.

II.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

III.Mjetet paguhen prej pozicionit buxhetor të mallrave dhe shërbimeve.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**BINAK KRYEZIU** nga Retija, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe nga dt.07.04.2022 i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit sipas Vendimit e Kryetarit të komunës nr.1790 dt.25.03.2022.

Sipas nenit nenit 22 paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 Për pagat e nëpunësve civil thuhet se nëpunësit civilë kanë të drejtat në " pagesën për shkak të pensionimit".

Gjithashtu, me nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë thuhet se **"nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore ."**

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i palës së ndjerë ( të nëpunësit), ka të drejt ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**KRYETARI**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Binak Kryeziut nga Retija
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
3. Zyra e Kryetarit të komunës
4. Dosja personale
5. Arkiva

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2302 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 20/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 22 të paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil si dhe nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

## V E N D I M

I.**ATIP KRYEZIU** nga Retija, ish shërbyes civil i administratës komunale të Rahovecit i bëhet kompensimi i një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, në emër të daljes në pension.

II.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

III.Mjetet paguhen prej pozicionit buxhetor të mallrave dhe shërbimeve.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m

**BINAK KRYEZIU** nga Retija, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Referent për palë pranë Drejtorisë për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë nga dt.20.02.2021 i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit sipas Vendimit e Kryetarit të komunës nr.046 dt.05.02.2021.

Sipas nenit nenit 22 paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 Për pagat e nëpunësve civil thuhet se nëpunësit civilë kanë të drejtat në " pagesën për shkak të pensionimit".

Gjithashtu, me nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë thuhet se **"nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore ."**

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i palës së ndjerë ( të nëpunësit), ka të drejt ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Atip Kryeziut nga Retija
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
3. Drejtorisë për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë
4. Dosja personale
5. Arkiva

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2303 Nr. i faq/Br.str/No pg 01
Data/Datum/Date 20/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 22 të paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil si dhe nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

**V E N D I M**

I.**MAHMUT HONDOZI** nga Rahoveci, ish shërbyes civil i administratës komunale të Rahovecit i bëhet kompensimi i një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, në emër të daljes në pension.

II.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

III.Mjetet paguhen prej pozicionit buxhetor të mallrave dhe shërbimeve.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**MAHMUT HONDOZI** nga Rahoveci, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar i Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale/ Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe nga dt.07.09.2021 i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit sipas Vendimit e Kryetarit të komunës nr.931 dt.07.09.2021.

Sipas nenit nenit 22 paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 Për pagat e nëpunësve civil thuhet se nëpunësit civilë kanë të drejtat në " pagesën për shkak të pensionimit".

Gjithashtu, me nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë thuhet se **"nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore ."**

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i palës së ndjerë ( të nëpunësit), ka të drejt ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Mahmut Hondozi nga Rahoveci
2. Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
3. Dosja personale
4. Arkiva

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2304 Nr. i faq/Br.str/No.pg 02
Data/Datum/Date 20/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 22 të paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil si dhe nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

**V E N D I M**

I.**ALI KRYEZIU** nga Xërxa, ish shërbyes civil i administratës komunale të Rahovecit i bëhet kompensimi i një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, në emër të daljes në pension.

II.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

III.Mjetet paguhen prej pozicioni buxhetor të mallrave dhe shërbimeve.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**ALI KRYEZIU** nga Xërxa, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Gjeometër për mirëmbajtjen dhe hartimin e kadastrit pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe nga dt.13.03.2022 i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit sipas Vendimit e Kryetarit të komunës nr.1454 dt.17.01.2022.

Sipas nenit nenit 22 paragrafit 2 të pikes 2 të Ligjit Nr. 03/L-147 Për pagat e nëpunësve civil thuhet se nëpunësit civilë kanë të drejtat në " pagesën për shkak të pensionimit".

Gjithashtu, me nenit 19 paragrafin 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë thuhet se **"nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore ."**

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i palës së ndjerë ( të nëpunësit), ka të drejt ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Ali Kryeziut nga Xërxa
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
3. Drejtoria për Gjeodezi,Kadastër dhe Pronë
4. Dosja personale
5. Arkiva

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2311 Nr. i faq/Br.str/No.pg 02
Data/Datum/Date 20/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit", me Nr. prokurimi: 623-22-4278-5-2-1 & 623-22-015-5-2-1 të datës: 02.06.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Diellza Çanta, kryesuese
   **1.2.** Nesim Kalajdzimi – Asistent në MZHR, anëtar
   **1.3.** Fidan Hoti, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për "Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit", me Nr. prokurimi: 623-22-4278-5-2-1 & 623-22-015-5-2-1 të datës: 02.06.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/2218/22 i datës 03.06.2022.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI/PREDSEDNIK OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2312 Nr. i faq/Br.str/No.pg 02
Data/Datum/Date 20/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 paragrafi 3 pika 3.1 i të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010 dhe nenit 11 paragrafi 6 pika 6.1 i Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për lejimin e pagesës shtesë për punë jashtë orarit të rregullt

1. Me këtë vendim **lejohet** pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës nga data 1 korrik 2022 për z. Muharem Morina, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar për rini, pranë Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.

2. I njëjti ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës që bënë për muajt e cekur në pikën 1 të këtij vendimi dhe atë 30% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.

3. Mjetet për pagesën e punëve jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe prodhon efekt juridik deri në marrjen e një vendimi tjetër.

*Arsyetim*

Duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve shtesë të caktuara nga Zyrtari Kryesor Administrativ për nëpunësin z. Muharem Morina, i cili për shkak të angazhimeve në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport është i obliguar që të punoj edhe jashtë orarit të punës në organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore dhe kulturore që janë pjesë e planprogramit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dher Sport, është e domosdoshme që të njëjtit ti bëhet kompensimi me pagesë 30% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Me vendim të njoftohen:***

- *Z. Muharem Morina,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyra e personelit, dhe*
- *Arkivi.*

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/ Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Prešednik Opstine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2316 Nr. i faq/Br.str/No.pg 03
Data/Datum/Date 21 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 2, nenit 20 dhe nenit 21 të Rregullores MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, nenit 5 të Rregullores për menaxhimin e pasurisë jofinanciare dhe inventari i papërdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22 të datës 30.03.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për emërimin e komisionit për vlerësimin e pasurive jo financiare dhe financiare jashtë përdorimit**

1. **Emërohet** komisioni për vlerësimin e pasurive jo financiare dhe financiare jashtë përdorimit në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
    - 1.1 Liridon Gashi, kryesues
    - 1.2 Tefik Krasniqi, anëtar
    - 1.3 Luan Sharku, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e pasurive jo financiare dhe financiare jashtë përdorimit të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në Rregulloren MF-Nr.02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore dhe Rregulloren e Komunës së Rahovecit për menaxhimin e pasurisë jofinanciare dhe inventari i papërdorshëm i komunës 01 Nr. 290/22 të datës 30.03.2022.

3. Komisioni do të filloje punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 23.06.2022.

4. Komisioni për vlerësimin e pasurive jo financiare dhe financiare jashtë përdorimit ka mandat 2 (dy) vjeçar.

5. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

1. ***Anëtarëve të komisionit,***
2. ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe***
3. ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2319 Nr. i faq/Br.str/No.pg 03
Data/Datum/Date 21/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisje lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 22 të paragrafit 2 të pikes 4 të Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e nëpunësve civil si dhe nenit 22 paragrafin 1 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

I.**ASLIHANE MEKANI** nga Drenoci i ndahet ndihma financiare në shumën ***370.57 € bruto*** për shkak të vdekjes së bashkëshortit Liman Mekani i cili ka qenë shërbyes civil i komunës së Rahovecit në pozitën Zyrtar i gjendjes civile-ofiqar pranë Drejtorisë për Administratë.

II.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

III.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Liman Mekani ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar i gjendjes civile (ofiqar) pranë Drejtorisë për Administratë .

Me vendimin nr.2223 të dt.03.06.2022 i pushon marrëdhënja e punës sipas vdekjes dhe me Certifikatën e vdekjes nr.ser.V10500370 Liman Mekani evidentohet në kategorin e personave te vdekur.

Sipas nenit nenit 22 paragrafit 2 të pikes 4 të Ligjit Nr. 03/L-147 Për pagat e nëpunësve civil thuhet se nëpunësit civilë kanë të drejtat në " ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil".

Gjithashtu, me nenit 22 paragrafin 1 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë thuhet se "në rast të vdekjes së një nëpunësi civil, familja e nëpunësit civil ka të drejtë të

marrë pagesë të njëherëshme në vlerë prej një (1) page mujore, që i paguhet bashkëshortit/es të shërbyesit civil ose anëtarit tjetër më të afërt të nëpunësit civil."

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendosi si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i palës së ndjerë ( të nëpunësit), ka të drejt ankesë në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Alslihane Mekanit nga Drenoci
2. Drejtoria për Administratë
3. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
4. Dosja personale
5. Arkiva

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2328 Nr. i faq/Br.str/No.pg 04
Data/Datum/Date 23/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit – Lot III", me Nr. prokurimi: 623-22-5885-5-2-5 & 623-20-033-5-1-1 të datës: 13.06.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Egzon Thaçi, kryesues
   **1.2.** Arta Kabashi, anëtare
   **1.3.** Liridon Gashi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për "Ndërtimi i rrugëve lokale në Komunën e Rahovecit – Lot III", me Nr. prokurimi: 623-22-5885-5-2-5 & 623-20-033-5-1-1 të datës: 13.06.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2329 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 23 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 56 paragrafi 1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 9 të Ligjit Nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, kërkesës me Nr. Prot. 1868 të datës 25.05.2022, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për ekzekutimin e mjeteve financiare**

1. Me këtë vendim **lejohet** ekzekutimi i mjeteve financiare për z. Avdilfaija Hajda nga Rahoveci, i cili ishte i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zjarrfikës – vozitës pranë Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Rahovecit për kompenzim të zjarrfikësve për periudhën 1.1.2021 deri 23.10.2021.

2. Mjetet të sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Lista për kompensim të zjarrfiksëve Rahovec, e datës 14.12.2021.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

z. Avdijfaija Hajda nga Rahoveci ka qenë i punësuar dhe i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zjarrfikës – vozitës pranë Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Rahovecit.
Duke u bazuar në nenin 9 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim i njëjti ka të drejtë në kompensim të zjarrfikësve për punën e kryer në kushte të veçanta, në detyrat e rrezikshme, punët jashtë orarit, orarin e punës me ndërrime, punën gjatë festave apo ditëve të tjera të pushimit si dhe shkathtësive të tyre të veçanta.
Për këtë arsye, të lartpërmendurit i takon kompensimi për periudhën 1.1.2021 deri me datë: 23.10.2021, kur edhe i është ndërpresë marrëdhënia e punës sipas fuqisë ligjore (pensionimit).

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos i në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***
- *z. Avdilfaija Hajda nga Rahoveci*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *Njësisë së Personelit, dhe*
- *Arkivit.*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna Rahovec*
*OpštinaOrahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Mayor Office**

Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2335 Nr. i faq/Br.str/No.pg 05
Data/Datum/Date 24/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) neneve 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

**Për formimin e komisionit për regjistrimin e sendeve të luajtshme nga lokalet Berber-Shop 1967 dhe Toni-Market që gjendet në ngastren kadastrale me P-71513005-01054-0 në vendin e quajtur Selo – Selo , Zona kadastrale Krusha e Madhe, komuna e Rahovecit**

1. Caktohet komisioni për regjistrimin - evidentimin e sendeve të luajtshme nga lokalet **Berber – Shop 1967** dhe **Toni - Market** që gjendet në ngastren kadastrale me **P-71513005-01054-0** në vendin e quajtur Selo – Selo, Zona kadastrale Krusha e Madhe në komunën e Rahovecit, në përbërje :

   1.1 Asllan Mazreku, kryesues
   1.2 Nazmi Krasniqi, anëtar
   1.3 Fadil Bugari, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të dalë në vend, të bëjë regjistrimin - evidentimin e sendeve të luajtshme nga lokalet **Berber – Shop 1967** dhe **Toni - Market** që gjenden në ngastren kadastrale me **P-71513005-01054-0** në vendin e quajtur Selo – Selo, Zona kadastrale Krusha e Madhe që gjendet në komunën e Rahovecit.

3. Obligohet Komisioni të hartojë një regjistër të detajuar për sendet të cilat gjenden në lokalet **Berber – Shop 1967** dhe **Toni - Market** në ngastren kadastrale me **P-71513005-01054-0** në vendin e quajtur Selo – Selo, Zona kadastrale Krusha e Madhe që gjendet në komunën e Rahovecit.

4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***U dërgohet :***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2343 Nr. i faq/Br.str/No.pg 05
Data/Datum/Date 28/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 59 paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

I.**ARBEN SOKOLI** nga Rahoveci, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar shpenzues pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në shërbimin civil** nga data 30.06.2022.

II.Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta heq nga lista e pagave.

III.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**ARBEN SOKOLI** nga Rahoveci, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar shpenzues pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa .

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani me imelin zyrtar të datë 15.06.2022 e ka njoftuar Njësin e personelit se Arben Sokoli ka dhënë dorëheqjen nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.

Sipas nenit 62 paragrafit 1 pika 1 e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon kur nëpunësi civil jep dorëheqje nga detyra.

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendos si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi pala ka të drejt ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Arben Sokoli
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
3. Dosja personale
4. Arkiva

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2344 Nr. i faq/Br.str/No.pg 06
Data/Datum/Date 28 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit – Hardhfest – faza përfundimtare", me Nr. prokurimi: 623-22-5963-5-2-1 & 623-22-023-5-2-1 të datës: 27.06.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Diellza Çanta, kryesuese
   **1.2.** Arta Kabashi, anëtare
   **1.3.** Egzon Thaqi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për "Ndërtimi i infrastrukturës për tregun e rrushit – Hardhfest – faza përfundimtare", me Nr. prokurimi: 623-22-5963-5-2-1 & 623-22-023-5-2-1 të datës: 27.06.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të filloje punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA - KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC - KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2345 Nr. i faq/Br.str/No.pg 06
Data/Datum/Date 28/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8 paragrafi 3 pika 3.2 dhe 3.3 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt propozimeve nga projekti ReLOaD2**

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt propozimeve të OJQ-ve nga projekti ReLOaD2 në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
   - 1.1 Ekrem Bytyqi, anëtar
   - 1.2 Saranda Shala, anëtare
   - 1.3 Muharem Morina, anëtar rezervë

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt propozimeve të OJQ-ve nga projekti ReLOaD2 në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit, duke u bazën e thirrjes publike për aplikim dhe në përputhje me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

3. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve dhe thirjen publike për aplikim.

4. Komisioni do të filloj punën menjëherë dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve sipas Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit.

6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Znj. Vlora Elshani, Menaxhere e projektit* ReLOaD2, *dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2346 Nr. i faq/Br.str/No.pg 06
Data/Datum/Date 28/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për asgjësimin e mallit të konfiskuar

1. **Caktohet** komisioni për asgjësimin e mallit të konfiskuar pa leje në hapësirën publike në Komunën e Rahovecit në këtë përbërje:

   **1.1.** Saranda Rama, kryesuese
   **1.2.** Valon Hoti, anëtar
   **1.3.** Arta Kabashi, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin dhe asgjësimin e mallit të konfiskuar pa leje në hapësirën publike në Komunën e Rahovecit.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Inspektim.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Inspektim, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**


REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2347 Nr. i faq/Br.str/No.pg 06
Data/Datum/Date 28 / 6 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizim me karrige stomatologjike", me Nr. prokurimi: 623-22-4578-1-2-1 & 623-22-012-1-2-1 të datës: 23.06.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Qazim Cana, kryesues
   **1.2.** Etnik Popaj, anëtar
   **1.3.** Liridon R. Gashi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për "Furnizim me karrige stomatologjike", me Nr. prokurimi: 623-22-4578-1-2-1 & 623-22-012-1-2-1 të datës: 23.06.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të filloje punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
[signature]
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2348 Nr. i faq/Br.str/No.pg 06
Data/Datum/Date 28/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM
## Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: "Furnizimi i shkollave me teknologji informative – tabela digjitale", me Nr. prokurimi: 623-22-4901-1-2-1 & 623-22-017-1-2-1 të datës: 27.06.2022, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues
   **1.2.** Liridon R. Gashi, anëtar
   **1.3.** Antigona Krasniqi, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për "Furnizimi i shkollave me teknologji informative – tabela digjitale", me Nr. prokurimi: 623-22-4901-1-2-1 & 623-22-017-1-2-1 të datës: 27.06.2022.

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2351 Nr. i faq/Br.str/No.pg 06
Data/Datum/Date 28/6/22
RAHOVEC, ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

## V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e znjsh[redacted] me Nr. Prot. 2108, të dt. 10.06.2022 për ndihmë financiare prej 400.00€ (katërqind euro) për mbulimin e shpenzimeve te mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman të sëmundjes.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe mjetet do të derdhen në xhirollogari të[redacted]. XK051931655848321169 në BKT Bank.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

### *A r s y e t i m*

[redacted] nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurin është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurës, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes së saj, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted]
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2352 Nr. i faq/Br.str/No.pg 26
Data/Datum/Date 29/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së z. Berat Duraku të datës 10.05.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM**
**Për lejimin e udhëtimit zyrtar**

1. Me këtë vendim znj. Bjondina Ramaj, e sistemuar në punë dhe detyrat e Zyrtare e lartë për mbrojtje të mjedisit, pranë Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit **i lejohet** udhëtimi zyrtar.

2. znj. Bjondina Ramaj do të marrë pjesë në vizitë studimore të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me GIZ, me temën "Menaxhimi i integruar i mbeturinave në Kosovë", e cila do të mbahet në Sofje të Bullgarisë nga data 03 -06 korrik 2022.

3. E lartpërmendura ka të drejtë të udhëtoj zyrtarisht, të zgjedh mënyrën e udhëtimit varësisht nga organizimi.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- *znj. Bjondina Ramaj,*
- *Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivi.*

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 16 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 8/2019"), nenit 22 paragrafi 2.3 i Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenit 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për pagesën e shpërblimit të përvjetorit (jubile)**

1. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa e z. Asllan Mazreku nga fsh. Opterushë Komuna e Rahovecit, me Nr. Prot. 1953 të dt. 31.5.2022, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Menaxher i aseteve pranë Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.
2. **LEJOHET** pagesa e shpërblimit jubilar të përvjetorit jubilar të marrëdhënies së pandërprerë të punës për 10 (dhjetë) vjet për nëpunësin sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. **AUTORIZOHET** Drejtoria për Buxhet dhe Financa që në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të kryejë pagesën në shumën prej 25% të pagës mesatare në shërbimin civil në emër të shpërblimit të përvjetorit (jubile) të parashtruesit të kërkesës dhe mjetet të derdhen në xhirollogarinë e të lartcekurit.

***Arsyetim***

Më datë 31.5.2022 z. Asllan Mazreku ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagesës jubilare për periudhën prej 06.02.2012 dhe në vazhdimësi deri në ditët e sotme si Menaxher i aseteve pranë Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.
Në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, kërkesa e të njëjtit është miratuar dhe atë për pagesën e shpërblimit jubilar për 10 (dhjetë) vite të punës së pandërprerë në shërbimin civil duke llogaritur nga dt. 13.05.2010 kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil deri në datën e parashtrimit të kërkesës, kjo për arsye se ligji në fjalë nuk e parasheh pagesën për vitet e mëhershme (retroaktive).
Vendimi bazohet në nenin 22 paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë i dt. 13 maj 2010 si dhe nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil të dt. 24.12.2012, në të cilët parashihet pagesa e shpërblimit të përvjetorit (jubile).
Andaj, pas shqyrtimit të kërkesës, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.
**Këshillë Juridike**: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***z. Asllan Mazreku nga fsh Opterushë,***
- ***Njësisë së Personelit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2362 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1
Data/Datum/Date 30/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2363 Nr. i faq/Br.str/No.pg 7
Data/Datum/Date 30/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e Shtabit komunal për korrje – shirje për vitin 2022**

1. Caktohet Shtabi komunal për korrje – shirje në Komunën e Rahovecit për vitin 2022, në këtë përbërje:

   **1.1** Berat Duraku, kryesues i shtabit
   **1.2** Ilvi Durguti, zv. kryesues i shtabit
   **1.3** Veton Mustafa, anëtar
   **1.4** Hasan Vuqitërna, anëtar
   **1.5** Milazim Elshani, anëtar
   **1.6** Nijazi Sokoli, anëtar
   **1.7** Bekim Krasniqi, anëtar

2. Shtabi Komunal ka për detyrë që të bëjë përcjelljen e korrje - shirjeve në teren në të gjithë territorin e Komunës së Rahovecit gjatë tërë fushatës së korrje - shirjeve deri në përfundim të saj.

3. Obligohet shtabi komunal që me kohë të njoftoj Kryetarin e Komunës dhe personat e tjerë kompetent nga sfera e bujqësisë si dhe Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me raport kohë pas kohe lidhur me rjedhën e korrje – shirjeve.

4. Shtabi Komunal për korrje – shirje do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë me përfundimin e tyre.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Shtabit Komunal dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

*Me vendim të njoftohen:*

- ***Anëtarët e Shtabit Komunal,***
- ***DBPZHR, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2371 Nr. i faq/Br.str/No.pg 8
Data/Datum/Date 30/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare në SHFMU "31 Marsi" në fshatin Guri i Kuq**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare të shkaktuara në SHFMU "31 Marsi" në fshatin Guri i Kuq, në përbërje prej:

   **1.1** Jeton Krasniqi, kryesues
   **1.2** Diellza Çanta, anëtare
   **1.3** Maliq Fetahaj – drejtor i shkollës, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e dëmeve materiale dhe financiare të shkaktuara në SHFMU "31 Marsi" në fshatin Guri i Kuq nga persona të papërgjegjshëm.

3. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punës të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Arsim në Komunën e Rahovecit.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojn në një afat të arsyeshëm.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Me vendim të njoftohen:***

- ***Anëtarët e komisionit,***
- ***Drejtoria për Arsim, dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 2372 Nr. i faq/Br.str/No.pg 8
Data/Datum/Date 30/6/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008), nenit 59 paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 si dhe nenit 92 të Statutit të komunës së Rahovecit, Kryetari i komunës bie:

**VENDIM**
**PËR PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS**

I.**GZIM MAKSHANA** nga Drenoci, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar për buxhet dhe financa 1 pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, **I PËRFUNDON marrëdhënia e punës në shërbimin civil** nga data 30.06.2022.

II.Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta heq nga lista e pagave.

III.Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IV.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

**GZIM MAKSHANA** nga Drenoci, ka qenë në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punët dhe detyrat e punës: Zyrtar për buxhet dhe financa 1 pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa .

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani me imelin zyrtar të datë 30.06.2022 e ka njoftuar Njësin e personelit se Gzim Makshana ka dorëzuar aktin e dorëheqjes me dt.29.06.2022 me të cilin ka dhënë dorëheqjen nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.

Sipas nenit 62 paragrafit 1 pika 1 e Ligjit për Zyrtarët Publik Nr.06/L-114 marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon kur nëpunësi civil jep dorëheqje nga detyra.

Prandaj, Kryetari i komunës pas administrimit të provave dhe fakteve mbi gjendjen reale, vendos si në dispozitiv të vendimit.

**KËSHILLA JURIDIKE**: Kundër këtij vendimi pala ka të drejt ankese në afatin prej 30 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të vendimit, Komisionit Komunal për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesa.

**K R Y E T A R I**
**Smajl Latifi**

**Kopja e vendimit iu dorëzohet:**
1. Gzim Makshana nga Drenoci
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
3. Dosja personale
4. Arkiva